- Kontrolloni flegelat e guarnicionit elastik (gri) dhe hiqni çdo gjë të vogël.
- Kontrolloni brenda kazanit dhe hiqni çdo gjë nga larja e mëparshme.



- Hiqni të gjitha rrobat ose gjërat nga guarnicioni elastik për të mos lejuar dëmtimin e rrobave dhe guarnicionit.



Shtimi i Produkteve të Pastrimit

Doza e Detergjentit

- Detergjenti duhet të përdoret sipas udhëzimeve të prodhuesit të detergjentit dhe llojit të zgjedhur dhe sipas llojit, ngjyrave, ndotjes të rrobave dhe temperaturës të larjes.
- Nëse përdoret tepër detergjent, mund të formohet shumë e tepërt dhe kjo do të sjellë rezultate larjeje të dobëta ose të shkaktojë ngarkesë të madhe në motor.
- Nëse doni të përdorni detergjent të lëngshëm, ndiqni udhëzimet e dhëna nga prodhuesi i detergjentit.
- Mund të hidhni detergjent të lëngshëm direkt në sirtarin kryesor të detergjentit nëse po e filloni ciklin menjëherë.
- Mos përdorni detergjent të lëngshëm nëse po përdorni Time delay, ose nëse keni zgjedhur Pre Wash, pasi lëngu mund të forcohet.
- Nëse formohet tepër shumë, ulni sasinë e detergjentit.
- Përdorimi i detergjentit mund të ketë nevojë të rregullohet sipas temperaturës, fortësisë të ujit, sasisë dhe nivelit të njollave të ngarkesës. Për rezultate më të mira, mos lejoni shumën e tepërt.
- Shikoni etiketën e rrobave para se të zgjidhni detergjentin dhe temperaturën e ujit.
- Kur përdorni lavatriçen, përdorni vetëm detergjent të caktuar për secilin lloj rrobash:
 - Detergjent i zakonshëm pluhur për të gjithë llojet e rrobave
 - Detergjent pluhur për rroba delikate
 - Detergjente të lëngshme për të gjitha llojet e rrobave ose detergjente të caktuara vetëm për lesh
- Për performancë larjeje dhe zbardhim më të mirë, përdorni detergjent me zbardhues pluhur të zakonshëm.
- Detergjenti merret me ujë nga dispenseri në fillim të ciklit.

SHËNIM

- Mos e lini detergjentin të ngurtësohet. Bërja e kësaj mund të çojë në bllokime, performancë shpërlarjeje të dobët ose erë.
- Ngarkesë e plotë: Sipas rekomandimeve të prodhuesit.
- Ngarkesë e pjesshme: 3/4 e sasisë normale
- Ngarkesë minimale: 1/2 e ngarkesës të plotë

Shtimi i Detergjentit dhe Zbutësit të Rrobave

Shtimi i detergjentit


- Vetëm larje kryesore → 
- Para larje + Larje kryesore → 

SHËNIM

- Tepër detergjent, zbardhues ose zbutës mund të shkaktojë rrjedhje sipër.
- Sigurohuni që të përdorni sasinë e duhur të detergjentit.

Shtimi i zbutësit të rrobave

- Mos e tejkaloni vijën maksimale të mbushjes. Mbushja e tepërt mund të shkaktojë futje të parakohshme të zbutësit të rrobave e cila mund të njollojë rrobat. Mbylleni sirtarin e dispenserit me ngadalë.




- Mos e lini zbutësin e rrobave në sirtarin e detergjentit për më shumë se 2 ditë (Zbutësi i rrobave mund të ngurtësohet).
- Zbutësi do të shtohet automatikisht gjatë ciklit të fundit të shpëlarjes.
- Mos e hapni sirtarin kur po hyn ujë.
- Nuk duhet të përdoren hollues (benzen, etj.).

SHËNIM

- Mos e hidhni zbutësin e rrobave direkt mbi rroba.


Shtimi i zbutësit të ujit

- Mund të përdoret një zbutës uji, si për shembull Anti-kalkar (p.sh. Calgon) për të pakësuar përdorimin e detergjentit në vende me ujë shumë të fortë. Hidhjeni sipas sasisë të treguar në paketim. Më parë hidhni detergjentin dhe pastaj zbutësin e ujit.
- Përdorni sasinë e detergjentit që duhet për ujë të butë.




Përdorimi i tabletave


- 1 Hapni derën dhe futni tabletat në kazan.



- 2 Futni rrobat në kazan dhe mbylleni derën.



Paneli i Kontrollit



1 Butoni Energji

- Shtypni butonin **Energji** për të ndezur lavatriçen.
- Shtypni dhe mbani shtypur butonin e energjisë për 1 sekondë për të mbyllur lavatriçen.

2 Butoni Nisje/Ndalim

- Ky buton **Nisje/Ndalim** përdoret për të filluar ciklin e larjes ose për të ndaluar ciklin e larjes.
- Nëse është e nevojshme një ndalesë e përkohshme e ciklit të larjes, shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

3 Ekran

- Ekran tregon konfigurimet, kohën e mbetur, opsionet dhe mesazhet e statusit. Kur produkti ndizet, parametrat standarde në ekran do të ndizen.
- **A**: Ekran tregon kohën e mbetur të llogaritur. Ndërkohë që madhësia e ngarkesës llogaritet automatikisht, pulson ose shfaqet 'u zbulua'.
- **B**: Temperatura e ujit shfaqet kur shtypni butonin e temperaturës **"Temp."**
- **C**: Niveli i rotullimeve të centrifugës shfaqet kur shtypni butonin e centrifugës **"Spin"**

4 Butoni i Programit

- Programet janë të disponueshme sipas llojit të rrobave.
- Do të ndizet llamba për të treguar programin e zgjedhur.

5 Opsionet

- Kjo ju lejon të zgjidhni automatikisht një cikël shtesë dhe do të ndizet kur zgjidhet.
- Përdorni këta butona për të zgjedhur opsionet e ciklit të dëshiruar për ciklin e zgjedhur.

Tabela e Programeve

Programi i Larjes

Programi	Përshkrim	Lloji i Copës	Temp. e Duhur	Ngarkesa maksimale
Cotton (Pambuk)	Jep performancë më të mirë duke kombinuar lëvizje të ndryshme të kazanit.	Copat me ngjyra (këmisha, rroba gjumi, pizhama, etj.) dhe pambuk me njolla normale (të brendshme).	40°C (l ftohtë deri në 95°C)	Vlerësimi
Cotton Large (Të pambukta të mëdha)	Jep performancë larjeje të optimizuar për sasi të mëdha rrobash me më pak konsum energjie.		60°C (l ftohtë deri në 60°C)	
Easy Care (Kujdes i Lehtë)	Ky cikël është i përshtatshëm për bluzat e zakonshme që nuk kanë nevojë për hekurosje pas larjes.	poliamid, akrilik, poliestër	40°C (l ftohtë deri në 60°C)	4,0 kg
Mix (Miks)	Bën të mundur që copat e ndryshme të lahen njëkohësisht.	Llojet e ndryshme të copave përveç materialeve të veçanta (mëndafsh/delikate, veshje sportive, rroba të errëta, lesh, mbulesë krevati/perde).	40°C (l ftohtë deri në 40°C)	
Allergy Care (Kujdes Alergjie)	Ndihmon për të hequr alergjentë si myku i shtëpisë, polena dhe qimet e maces.	pambuk, të brendshme, mbulesa jastëku, çarçafë, rroba fëmijësh	60°C	
Silent Wash (Larje e Heshtur)	Bën më pak zhurmë dhe dridhje dhe kursen para duke përdorur energjinë elektrike gjatë natës.	Veshjet me ngjyra (bluza, rroba gjumi, pizhame, etj.) dhe të pambukta të ndotura lehtë (të brendshme).	40°C (l ftohtë deri në 60°C)	5,0 kg
Steam Refresh (Rifreskim Avulli)	Ndihmon për të hequr rrudhat brenda 20 min me avull (Rrobat mund të jenë të njoma. Mund t'i vishni pasi t'i keni varur për t'u tharë për 10–30min).	bluza, këmisha me përzierje pambuku, përzierje poliestri	Asnjë zgjedhje	3 gjëra
Duvet (Jorgan)	Ky cikël është për gjëra të mëdha di mbulesa krevati, jastëkë, mbulesa divanësh, etj.	Shtresat e pambukut përveç copave të veçanta (delikate, lesh, mëndafsh, etj.) me mbushje: mbulesa krevati, jastëkë, çarçafë, mbulesa divanësh me mbushje të lehtë	40°C (l ftohtë deri në 40°C)	1 madhësi teke
Sports Wear (Veshje Sportive)	Ky cikël është i përshtatshëm për veshje sportive si rroba kërcimi dhe vrapit.	coolmax, gore-tex, fleece dhe sympatex		3,0 kg
Dark Wash (Larje të Errëta)	Nëse ka mundësi që rrobat të ç'ngjyrosen, ju lutem përdorni këtë cikël. Cikli parandalon ç'ngjyrosjen. (Ju lutem përdorni detergjent për rroba me ngjyrë.)	Veshjet e errëta prej pambuku ose copa të përziera.	20°C (l ftohtë deri në 40°C)	

Programi	Përshkrim	Lloji i Copës	Temp. e Duhur	Ngarkesa maksimale
Speed 14 (Shpejtësi 14)	Ky cikël bën larje të shpejtë për ngarkesa të vogla dhe rroba të ndotura lehtë.	Robat me ngjyra që janë të ndotura lehtë. KUJDES: Përdorni më pak se 20 g detergjent (për ngarkesë 2.0 kg) përndryshe mund të mbetet detergjent mbi rroba.	20°C (20°C deri 40°C)	2,0 kg
Gentle Care (Kujdes i Butë)	Ky cikël është për rroba delikate që lahen me dorë dhe lavatriçe si për shembull lesh, të brendshme, fustanë, etj. (Përdorni detergjentë për të lehtëta që lahen me lavatriçe.)	lesh, rroba që lahen me dorë, delikate, rroba të dëmtuara lehtë	20°C (I ftohtë deri në 30°C)	1,5 kg
Stain Care (Kudjes Njollash)	Lani llojet e ndryshme të njollave si verën, lëngun e frutave, baltën, etj. (Temperatura e larjes rritet hap pas hapi për të larë njollat e ndryshme.)	copa me përzierje pambuku, JO rroba delikate	40°C (30°C deri 60°C)	3,0 kg
Download Cycle (Shkarko Cikël)	Për cikle që mund të shkarkohen. Nëse nuk keni shkarkuar asnjë cikël, standardi është Rinse+Spin.			

- Temperatura e Larjes: Zgjidhni temperaturën e përshtatshme të ujit për ciklin e zgjedhur të larjes. Gjithmonë ndiqni etiketën ose udhëzimet e prodhuesit kur lani.
- Vendosni programin në opsionin “Të pambukta të mëdha 40°C (Gjysmë ngarkesë)”, “Të pambukta të mëdha 60°C (Gjysmë ngarkesë)”, “Të pambukta të mëdha 60°C (Kompletно Napunjen)” për testim në lidhje me përshtatjen me EN60456 dhe Rregullorja 1015/2010.
 - Standard 60°C programi pambuk : Të pambukta të mëdha ☐ + ☐ 60°C (Ngarkesë e plotë)
 - Standard 60°C programi pambuk : Të pambukta të mëdha ☐ + ☐ 60°C (Gjysmë ngarkesë)
 - Standard 40°C programi pambuk : Të pambukta të mëdha ☐ + ☐ 40°C (Gjysmë ngarkesë)
 (Ato janë të përshtatshme për të pastruar njollat tek veshjet e pambukta)
 (Ato janë programet më efikente në terma të energjisë së kombinuar dhe konsumimit të ujit për larjen e atij lloji pambuku.)
 * Temperatura aktuale e ujit mund të variojë nga temperatura e deklaruar e ciklit.
- Rezultatet e testimit varen nga presioni i ujit, fortësia e ujit, temperatura e ujit në hyrje, temperatura e dhomës, tipi dhe sasia e ngarkesës, masa e detergjentit, luhatjet në furnizimin kryesor me energji dhe opsione shtesë të zgjedhura.

SHËNIM

- Rekomandohet detergjent neutral.

Opsionet Ekstra

Programi	Delay (Shtyrje Kohe)	Steam Wash (Larje me Avull)	Steam Softener (Zbutje me Avull)	Favorite (I preferuar)	Pre Wash (Para Larje)	Medic Rinse (Shpëlarje Mjekësore)	Rinse+ (Shpëlarje+)	Rinse Hold (Shpëlarja ndalon)	Turbo Wash (Larje Turbo)	Intensive (Intensiv)
Cotton (Pambuk)	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
Cotton Large (Të pambukta të mëdha)	•	•	•	•	•	•	•	•	•	
Easy Care (Kujdes i Lehtë)	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
Mix (Miks)	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
Allergy Care (Kujdes Alergjie)	•	•*		•		•	•	•		•
Silent Wash (Larje e Heshtur)	•			•			•	•		•
Steam Refresh (Rifreskim Avulli)		•*		•						
Duvet (Jorgan)	•	•		•			•	•		•
Sports Wear (Veshje Sportive)	•			•			•	•		•
Dark Wash (Larje të Errëta)	•			•			•	•		•
Speed 14 (Shpejtësi 14)	•			•			•		•*	
Gentle Care (Kujdes i Butë)	•			•			•			
Stain Care (Kudjes Njollash)	•			•	•*	•	•	•		

* : Ky opsion është përfshirë automatikisht në cikël dhe nuk mund të fshihet.

Të Dhënat e Punimit

Programi	RPM maksimale
Cotton (Pambuk)	1400
Cotton Large (Të pambukta të mëdha)	1400
Easy Care (Kujdes i Lehtë)	1000
Mix (Miks)	1400
Allergy Care (Kujdes Alergjie)	1400
Silent Wash (Larje e Heshtur)	1000
Steam Refresh (Rifreskim Avulli)	-
Duvet (Jorgan)	1000
Sports Wear (Veshje Sportive)	800
Dark Wash (Larje të Errëta)	1400
Speed 14 (Shpejtësi 14)	800
Gentle Care (Kujdes i Butë)	800
Stain Care (Kudjes Njollash)	1400

SHËNIM

- Informacion në programet kryesore në gjysëm ngarkimin.

Programi	Koha në minuta	Përmbajtja e mbetur e lagështisë	Ujë në litra	Energjia në kWh
Cotton (Pambuk) (40°C)	96	40 %	66	0,72
Cotton Large (Të pambukta të mëdha) (60°C)	270	44 %	37	0,63

Cikël Opsion

Delay (Shtyrje Kohe)

Mund të vendosni një shtyrje kohe në mënyrë që lavatriçja të fillojë dhe mbarojë automatikisht pas një kohe të caktuar.

- 1 Shtypni butonin **Energji**.
- 2 Zgjidhni një program larjeje.
- 3 Shtypni butonin **Delay** dhe vendosni kohën që ju duhet.
- 4 Shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

SHËNIM

- Shtyrja e kohës është koha për mbarimin e programit, jo fillimin. Koha e vërtetë e punimit mund të ndryshojë sipas temperaturës të ujit, ngarkesës dhe faktorëve të tjerë.

Medic Rinse (Shpëlarje Mjekësore)

Për rezultime më të mira ose për shpëlarje më të pastër. Kjo bën të mundur që shpëlarja e fundit të ngrohet në 40 gradë.

- 1 Shtypni butonin **Energji**.
- 2 Zgjidhni një program larjeje.
- 3 Shtypni butonin **Medic Rinse** dhe vendosni kohën që duhet.
- 4 Shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

Steam (Avull) (Opsional)

Larje me Avull ka një performancë larjeje të lartë me konsum energjie të ulët. Zbutje me Avull spërkat avull pas një cikli tharjeje për të pakësuar rrudhat dhe për t'i bërë rrobat të shkrifëta.

- 1 Shtypni butonin **Energji**.
- 2 Për opsionin Larje me Avull, zgjidhni ciklet e avullit. Për opsionin Zbutje me Avull, zgjidhni Cotton ose Cotton Large, Mix, Easy Care.
- 3 Cikli i mëposhtëm zgjidhet në varësi të numrit të herëve që shtypni butonin **Steam**.
 - Një herë: Larje me Avull
 - Dy herë: Zbutje me Avull
 - Tre herë: Larje me Avull dhe Zbutje me Avull
- 4 Shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

Steam Wash (Larje me Avull) ()

- Për rrobat shumë të ndotura, të brendshmet ose rrobat e bebeve.
- I disponueshëm me ciklet Cotton, Cotton Large, Mix, Easy Care, Duvet, Allergy Care, Steam Refresh.
- Mos përdorni Larje me Avull për rrobat që ç'ngjyrosen lehtë dhe delikatet si leshi, mëndafshi.

Steam Softener (Zbutje me Avull) ()

- I mirë për të zbutur dhe shkrifëtuar copat pas tharjes me ajër.
- I disponueshëm me ciklet Cotton, Cotton Large, Mix, Easy Care.
- Mos përdorni Zbutje me Avull për rrobat që ç'ngjyrosen lehtë dhe delikatet si leshi, mëndafshi.
- Në varësi të llojit të copave, performanca e zbutjes mund të jetë e ndryshme.

Favorite (I preferuar)

Programi i preferuar ju lejon të ruani një cikël larjeje të personalizuar për ta përdorur në të ardhmen.

- 1 Shtypni butonin **Energji**.
- 2 Zgjidhni një program larjeje.
- 3 Zgjidhni ciklin (Mënyra e larjes, numri i shpëlarjeve, shpejtësia e centrifugës, temperatura e ujit, etj.).
- 4 Shtypni dhe mbani shtypur butonin **Favorite** për 3 sekonda.

Programi i preferuar tani është ruajtur për t'u përdorur në të ardhmen.

Për ta përdorur përsëri programin, zgjidhni programin e preferuar dhe shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

Pre Wash (Para Larje)

Nëse rrobat janë shumë të ndotura, rekomandohet cikli Pre Wash.

- 1 Shtypni butonin **Energji**.
- 2 Zgjidhni një program larjeje.
- 3 Shtypni butonin **Pre Wash**.
- 4 Shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

Wash (Larje)

Turbo Wash (Turbo Larje)

Cikël larjeje në më pak se 1 orë me kursim energjie dhe uji. (bazuar në gjysmë ngarkese rrobash)

Intensive (Intensiv)

Nëse rrobat janë të ndotura normal dhe shumë, opsioni **Intensive** është i efektshëm.

Temp. (Temp.)

Butoni **Temp.** zgjedh kombinimin e temperaturës të larjes dhe tharjes për ciklin e zgjedhur. Shtypeni këtë buton derisa konfigurimi i dëshiruar të ndizet. Të gjitha shpëlarjet përdorin ujë të ftohtë çezme.

- Zgjidhni temperaturën e ujit të përshtatshme për llojin e ngarkesës që po lani. Ndiqni udhëzimet në etiketat e rrobave për rezultate më të mira.

Rinse (Shpëlarje)

Rinse+ (Shpëlarje+)

Shtoni shpëlarjen një herë.

Rinse Hold (Shpëlarja ndalon)

Cikli ndalohet derisa të shtypet butoni përsëri kur shpëlarja ka mbaruar.

Spin (Centrifugë)

- Niveli i shpejtësisë të centrifugës mund të zgjidhet duke shtypur butonin **Spin** vazhdimisht.
- Vetëm Centrifugë

- 1 Shtypni butonin **Energji**.
- 2 Shtypni butonin **Spin** për të zgjedhur RPM.
- 3 Shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.

SHËNIM

- Kur zgjidhni 'No Spin', do të fillojë të rrotullohet për një kohë të shkurtër për t'u shkarkuar shpejt.

Child Lock (Kyçi i Fëmijës) ()

Zgjidhni këtë funksion për të kyçur butonat në panelin e kontrollit për të mos lejuar ngacmimin.

Kyçja e panelit të kontrollit

- 1** Shtypni dhe mbani shtypur butonin **Child Lock** për 3 sekonda.
- 2** Do të bjerë një tingull sinjali dhe 'L' do të shfaqet në ekran.
Kur kyçi i fëmijës është i vendosur, të gjithë butonat kyçen përveç butonit **Energji**.

SHËNIM

- Fikja e energjisë nuk do ta fshijë funksionin e kyçit të fëmijës. Duhet të çaktivizoni kyçin e fëmijës para se të përdorni ndonjë prej funksioneve të tjera.

Zhbllokimi i panelit të kontrollit

Shtypni dhe mbani shtypur butonin **Child Lock** për 3 sekonda.

- Do të bjerë një tingull sinjalizues dhe koha e mbetur për programin aktual do të shfaqet përsëri në ekran.

Beep On / Off

- 1** Shtypni butonin **Energji**.
- 2** Shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.
- 3** Shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht butonin **Temp.** dhe **Rinse** për 3 sekonda për të vendosur funksionin Beep on/off.

SHËNIM

- Pasi të vendoset funksioni Beep on/off, konfigurimi ruhet në memorie edhe pasi të fiket energjia.
- Nëse doni ta fikni Sinjalizuesin, thjesht përsëritni këtë proces.

Përdorimi i Funksionit Smart (Opsional)

Përdorimi i Funksionit Tag On

Funksioni Tag On ju lejon të përdorni me lehtësi veçoritë LG Smart Diagnosis™ dhe Shkarkim Cikli për të komunikuar me pajisjen tuaj direkt nga produkti smartfoni juaj.

- Funksioni Tag On ju lejon të përdorni me lehtësi veçoritë LG Smart Diagnosis™ dhe Shkarkim Cikli për të komunikuar me pajisjen tuaj direkt nga produkti smartfoni juaj.

Instalimi i aplikacionit

- Kërkoni LG Smart Laundry në the Google Play Store nga telefoni juaj.



Përdorimi i Aplikacionit

Aplikacioni LG Smart Laundry ju lejon të përdorni veçori të ndryshme për lehtësinë tuaj.

- Shkarkim Cikli
- Smart Diagnosis™
- Tag On Vendosje Cikli
- Statistika të Larjeve

SHËNIM

- Shtypni  në aplikacionin LG Smart Laundry për udhëzime më të detajuara se si ta përdorni funksionin Tag On.
- Në varësi të prodhuesit të smartfonit dhe versionit OS Android, procesi i aktivizimit të NFC mund të ndryshojë. Shikoni manualin e smartfonit tuaj për hollësi.
- Për shkak të karakteristikave të NFC, nëse distanca e transmetimit është shumë larg, nëse ka një ngjitëse metalike ose kasë mbrojtëse në telefonin tuaj, transmetimi nuk do të jetë i mirë. Në disa raste, telefonat me NFC mund të mos jenë në gjendje të transmetojnë me sukses.
- Materialet që ndodhen në këtë manual mund të ndryshojnë në varësi të aplikacionit LG Smart Laundry dhe mund të ndryshohen pa i njoftuar klientët.

Deklarata e Konformitetit të BE



LG Electronics këtu deklaron se ky produkt është në përputhje me Direktivat e mëposhtme.

Direktiva R&TTE 1999/5/EC



PARALAJMËRIM

- Hiqeni lavatriçen nga priza para se ta pastroni për të shmangur rrezikun e goditjeve elektrike. Mos ndjekja e këtyre paralajmërimeve mund të çojë lëndime serioze, zjarr, goditje elektrike ose vdekje.
- Asnjëherë mos përdorni lëndë kimike të forta, pastrues gërryes ose hollues për të pastruar lavatriçen. Ato mund të dëmtojnë lustrën.

Pastrimi i Lavatriçes Tuaj

Kujdesi Pas Larjes

- Pasi cikli të ketë mbaruar, fshijeni derën dhe pjesën e brendshme të gominës të derës për të hequr lagështinë.
- Lëreni derën të hapur që të thahet pjesa e brendshme e kazanit.
- Fshijeni trupin e lavatriçes me një leckë të thatë për të hequr lagështinë.

Pastrimi i Pjesës të Jashtme

Kujdesi i mirë i lavatriçes tuaj mund të zgjatë jetën e saj.

Dera:

- Lajeni me një leckë të njomë nga jashtë dhe brenda dhe pastaj fshijeni me një leckë të thatë e të butë.

Pjesa e Jashtme:

- Fshijeni menjëherë pas çdo spërkatjeje.
- Fshijeni me një leckë të njomë.
- Mos e shtypni sipërfaqen ose ekranin me objekte të mprehta.


Kujdesi dhe Pastrimi i Pjesës të Brendshme

- Përdorni një peshqir ose leckë të butë për të fshirë rrotull hapësirës të derës të lavatriçes dhe xhamit të derës.
- Gjithmonë hiqini gjërat nga lavatriçja sapo të mbarojë cikli. Lënia e gjërave të njoma në lavatriçe mund të shkaktojë rrudha, kalim të ngjyrave dhe erë.
- Vini në punë ciklin Pastrim Kazani njëherë në muaj (ose më shpesh nëse është e nevojshme) për të hequr grumbullimin e detergjentit dhe mbetjet e tjera.


Pastrimi i Filtrit të Hyrjes të Ujit

- Mbylleni rubinetin nëse lavatriçja do të lihet për një kohë të gjatë (p.sh. gjatë pushimeve), veçanërisht nëse nuk ka shkarkim në dysheme (ulluk) pranë.
- Ikona 'I E' do të shfaqet në panelin e kontrollit kur nuk hyn ujë në sirtarin e detergjentit.
- Nëse uji është shumë i fortë ose përmban gjurmë të depozitimit të kalkareve, filtri i hyrjes të ujit mund të bllokohet. Prandaj është ide e mirë që ta pastroni me raste.

- 1 Mbylleni rubinetin e ujit dhe zhvidhosni tubin e hyrjes të ujit.




- 2 Pastroni filtrin duke përdorur një furçë me qime të forta.



Pastrimi i Filtrit të Pompës të Shkarkimit

- Filtri i shkarkimit grumbullon qimet dhe objektet e vogla të mbetura në rroba. Kontrolloni rregullisht që filtri të jetë i pastër për të siguruar punim të mirë të lavatriçes.
- Lëreni ujin të ftohet para se të pastroni pompën e shkarkimit, të bëni zbrazje emergjente ose të hapni derën në rast emergjence.


1 Hapeni tapën e kapakut dhe tërhiqeni tubin.




2 Nxirreni tapën e shkarkimit dhe hapeni filtrin duke e rrotulluar në të majtë.




3 Hiqni çdo lëndë të huaj nga filtri i pompës.



4 Pas pastrimit, rrotulloni filtrin dhe futni tapën e shkarkimit.



5 Mbylleni tapën e kapakut.




! Kujdes

- Më parë shkarkoni duke përdorur tubin e shkarkimit dhe pastaj hapni filtrin e pompës për të hequr fijet ose objektet e huaja.
- Bëni kujdes gjatë shkarkimit pasi uji mund të jetë i nxehtë.

Pastrimi i Sirtarit të Dispenserit

Detergjenti dhe zbutësi i rrobave mund të grumbullohet në sirtarin e dispenserit. Hiqeni sirtarin dhe insertet dhe kontrolloni për grumbullin njëherë ose dy herë në muaj.

- 1 Hiqeni sirtarin e dispenserit të detergjentit duke e tërhequr drejt derisa të ndalojë.
 - Shtypni fort butonin e shkëputjes dhe hiqeni sirtarin.



- 2 Hiqni insertet nga sirtari.
 - Shpëlani insertet dhe sirtarin me ujë të ngrohtë për të hequr grumbullimet nga produktet e larjes të rrobave. Përdorni vetëm ujë për të pastruar sirtarin e dispenserit. Thani insertet dhe sirtarin me një leckë ose peshqir të butë.
- 3 Për të pastruar hapësirën e sirtarit, përdorni një leckë ose furçë të vogël jo-metalike për të pastruar hapësirën.
 - Hiqni të gjitha mbetjet nga pjesët e sipërme dhe të poshtme të hapësirës.
- 4 Fshini lagështinë e hapësirës me një leckë të butë ose peshqir.
- 5 Ktheni insertet në vendet e tyre dhe vendosni përsëri sirtarin.

Tub Clean (Pastrimi i Kazanit) (Opsional)

Pastrimi i Kazanit është një cikël i veçantë për të pastruar pjesën e brendshme të lavatriçes.

Në shpejtësi centrifuge më të lartë përdoret një nivel uji më i lartë. Bëjeni këtë cikël rregullisht.

- 1 Hiqni rrobat ose gjërat nga lavatriçja dhe mbylleni derën.
- 2 Hapeni sirtarin e dispenserit dhe Shtoni antikalkar (p.sh. Calgon) në ndarjen e larjes kryesore.
- 3 Mbylleni sirtarin e dispenserit me ngadalë.
- 4 Ndizeni dhe pastaj shtypni e mbani shtypur butonin **Tub Clean** për 3 sekonda. Pastaj 't c l' do të shfaqet në ekran.
- 5 Shtypni butonin **Nisje/Ndalim** për të filluar.
- 6 Pasi cikli të ketë mbaruar, lëreni derën të hapur që hapësira e derës të lavatriçes, guarnicioni elastik dhe xhami i derës të thahen.

⚠ KUJDES

- Nëse ka fëmijë, bëni kujdes të mos e lini derën të hapur për kohë të gjatë.

SHËNIM


- Mos shtoni detergjent në ndarjet e detergjentit. Mund të krijohet shkumë e tepërt dhe të rrjedhë nga lavatriçja.

Kujdes nga Ngrirja Gjatë Dimrit


- Kur është i ngrirë, produkti nuk punon normalisht. Sigurohuni që ta montoni produktin aty ku nuk ngrin gjatë dimrit.
- Në rast se produkti duhet të instalohet jashtë ose në verandë apo në kushte të tjera jashtë, sigurohuni që të kontrolloni të mëposhtmet.

Si të Mos e Lejoni Produktin të Ngrijë

- Pas larjes, hiqni ujin e mbetur brenda pompës plotësisht me hapjen e tapës të tubit të përdorur për heqjen e ujit të mbetur. Kur të jetë hequr uji plotësisht, mbylleni tapën e tubit të përdorur për heqjen e ujit të mbetur dhe tapën e kapakut.




- Vareni poshtë tubin e shkarkimit për të nxjerrë plotësisht ujin.



⚠ KUJDES

- Kur tubi i shkarkimit montohet në formë me kthesë, tubi i brendshëm mund të ngrijë.

- Pasi të mbyllni rubinetin, shkëputeni tubin e hyrjes të ujit të ftohtë nga rubineti dhe hiqni ujin ndërsa e mbani tubin të drejtuar poshtë.




Kontrolloni për Ngrirje

- Nëse uji nuk zbrazet kur hapni tapën e tubit të përdorur për heqjen e ujit të mbetur, kontrolloni njësinë e shkarkimit.



- Ndizeni energjinë, zgjidhni Rinse dhe Spin, dhe shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.




SHËNIM

- Kontrolloni që uji vjen në sirtarin e detergentit gjatë shpëlarjes, dhe uji zbrazet përmes tubit të shkarkimit gjatë centrifugës.
- Kur 'F F' shfaqet në dritaren e ekranit kur produkti është në punë, kontrolloni njësinë e furnizimit të ujit dhe njësinë e shkarkimit (Disa modele nuk kanë një funksion alarmi që tregon ngrirje).

Si të Trajtoni Ngrirjen

- Sigurohuni që ta zbrazni kazanin, hidhni ujë të ngrohtë 50–60°C deri te pjesa e gomës brenda kazanit, mbylleni derën dhe prisni 1–2 orë.



⚠ KUJDES


- Mos përdorni ujë të valuar. Mund të shkaktojë djegie ose dëmtime në produkt.
- Hapeni tapën e kapakut dhe tapën e tubit të përdorur për të hequr ujin mbetur për ta nxjerrë ujin plotësisht.



SHËNIM


- Nëse uji nuk zbrazet, kjo do të thotë që akulli nuk ka shkrirë plotësisht. Prisni akoma.

- Kur uji të jetë hequr plotësisht nga kazanin, mbylleni tapën e tubit për heqjen e ujit të mbetur, zgjidhni Rinse dhe Spin, dhe shtypni butonin **Nisje/Ndalim**.



SHËNIM


- Kontrolloni që uji vjen në sirtarin e detergjentit gjatë shpëlarjes, dhe uji zbrazet përmes tubit të shkarkimit gjatë centrifugës.
- Kur ndodhin probleme me furnizimin me ujë, merrni masat e mëposhtme.
 - Mbylleni rubinetin, dhe shkrijeni rubinetin dhe të dy vendet e lidhjes të tubit të hyrjes në produkt duke përdorur një leckë me ujë të nxehtë.
 - Nxirreni tubin e hyrjes dhe zhyteni në ujë të ngrohtë nën 50–60°C.



Përdorimi i FunkSIONIT Smart Diagnosis™

Përdoreni këtë funksion nëse ju duhet një diagnozë e saktë nga qendra e shërbimit të LG Electronics kur produkti ka defekt ose prishet. Përdoreni këtë funksion vetëm për të kontaktuar përfaqësuesin e shërbimit, jo gjatë punimit normal.

- 1 Shtypni butonin **Energji** për ta ndezur lavatriçen. Mos shtypni asnjë buton tjetër ose mos rrotulloni rrotullën e zgjedhjes të ciklit.
- 2 Kur t'ju udhëzohet nga një qendër telefonatash, vendoseni pjesën e gojës të telefonit pranë butonit **Energji**.



- 3 Shtypni dhe mbani shtypur butonin **Temp.** për 3 sekonda ndërsa mbani pjesën e gojës të telefonit në ikonën ose butonin **Energji**.
- 4 Mbajeni telefonin në vend derisa transmetimi i tonit të ketë mbaruar. Shfaqet koha e mbetur për transferimin e të dhënave.
 - Për rezultate më të mira, mos e lëvizni telefonin ndërsa po transmetohen tonet.
 - Nëse agjenti i qendrës së telefonatave nuk është në gjendje të marrë një regjistrim të saktë të të dhënave, mund t'ju kërkohet ta provoni përsëri.



Qendra e shërbimit
LG Electronics

- 5 Pasi numërimi mbrapsht të ketë mbaruar dhe tonet të kenë ndaluar, vazhdoni bisedën me agjentin e qendrës së telefonatave i cili do të jetë në gjendje t'ju ndihmojë duke përdorur të dhënat e transmetuara për analizë.

SHËNIM

- Funksioni i Smart Diagnosis™ varet nga cilësia e telefonatës lokale.
- Performanca e komunikimit do të përmirësohet dhe mund të merrni një shërbim më të mirë nëse përdorni telefonin e shtëpisë.
- Nëse transferimi i të dhënave të Smart Diagnosis™ është i dobët për shkak të cilësisë të dobët të telefonatës, mund të mos merrni shërbimin më të mirë të Smart Diagnosis™.

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

- Lavatriçja juaj është e pajisur me një sistem automatik të monitorimit të gabimeve për të zbuluar dhe diagnostikuar problemet në një fazë të hershme. Nëse lavatriçja juaj nuk funksionon mirë ose nuk funksionon fare, kontrolloni të mëposhtmet para se të telefononi shërbimin:

Diagnostikimi i Problemeve

Simptomat	Arsyeja	Zgjidhja
Zhurme kërcitjeje dhe kërkëllitjeje	Objekte të huaja si monedha ose gjilpëra mund të kenë mbetur në pompë ose kazan.	• Ndalojeni lavatriçen, kontrolloni kazanin dhe filtrin e shkarkimit. • Nëse zhurma vazhdon pasi lavatriçja të ketë rifilluar, telefononi qendrën e shërbimit të autorizuar.
Zhurme e fortë	Ngarkesat e rënda të larjes mund të krijojnë zhurmë të fortë. Kjo zakonisht është normale.	• Nëse zhurma vazhdon, lavatriçja ka mundësi të mos jetë në ekuilibër. Ndalojeni dhe shpërndani mirë ngarkesën e larjes.
Zhurma dridhjeje	A janë hequr të gjithë bulonat e transportit dhe mbajtësi i kazanit?	• Nëse nuk janë hequr gjatë instalimit, shikoni udhëzimet e instalimit për heqjen e bulonave të transportit.
	A qëndrojnë fort mbi tokë këmbët?	• Ngarkesa e larjes mund të jetë e shpërndarë jo mirë në kazan. Ndalojeni lavatriçen dhe përhapni mirë ngarkesën e larjes.
Rrjedhje uji	Tubat e hyrjes ose tubi i shkarkimit është liruar te rubineti ose lavatriçja.	• Kontrolloni dhe shtrëngoni lidhjet e tubit.
	Tubat e shkarkimit të shtëpisë janë bllokuar.	• Zhblokonte tubin e shkarkimit. Kontaktoni me hidraulikun nëse është e nevojshme.
Shkumë e tepërt		• Detergjenti i tepërt ose i papërshtatshëm mund të shkaktojë formim të tepërt të shkumës e cila mund të rezultojë në rrjedhje uji.
Nuk hyn ujë në lavatriçe ose hyn ngadalë	Furnizimi me ujë nuk është i përshtatshëm në atë vend.	• Kontrolloni një rubinet tjetër në shtëpi.
	Rubineti i furnizimit me ujë nuk është plotësisht i hapur.	• Hapeni plotësisht rubinetin.
	Tubi(at) e hyrjes të ujit janë përdredhur.	• Drejtoni tubin.
	Filtri i tubit(ave) të hyrjes janë bllokuar.	• Kontrolloni filtrin e tubit të hyrjes.
Uji në lavatriçe nuk zbrazet ose zbrazet me ngadalë	Tubi i shkarkimit është përdredhur ose bllokuar.	• Pastroni dhe drejtoni tubin e shkarkimit.
	Filtri i shkarkimit është bllokuar.	• Pastroni filtrin e shkarkimit.

Simptomat	Arsyeja	Zgjidhja
Lavatriçja nuk ndizet	Kablli i energjisë elektrike mund të mos jetë lidhur në prizë ose lidhja mund të jetë e lirë.	• Sigurohuni që spina futet fort në prizën në mur.
	Siguresa është djegur, automati është rrëzuar ose ka ndodhur ndërprerje energjie.	• Ngrini automatin ose ndërroni siguresën. Mos e rritni kapacitetin e siguresës. Nëse problemi është mbingarkesë e qarkut, rregullojeni me një elektrikist të kualifikuar.
	Rubineti i furnizimit me ujë nuk është hapur.	• Hapeni rubinetin e furnizimit me ujë.
Lavatriçja nuk rrotullohet	Kontrolloni që dera është e mbyllur fort.	• Mbylleni derën dhe shtypni butonin Nisje/Ndalim. Pasi të keni shtypur butonin Nisje/Ndalim, mund të duhen disa momente para se lavatriçja të fillojë të rrotullohet. Dera duhet të jetë e kyçur para se të fillojë rrotullimi. Shtoni 1 ose 2 gjëra të ngjashme për të ndihmuar balancimin e ngarkesës. Përhapni ngarkesën për të lejuar centrifugim të mirë.
Dera nuk hapet		• Pasi të ketë filluar lavatriçja, dera nuk mund të hapet për arsye sigurie. Kontrolloni nëse ikona 'Kyçi i Derës' është e ndezur. Mund ta hapni në mënyrë të sigurt derën pasi ikona 'Kyçi i Derës' të fiket.
Koha e ciklit të larjes shtyhet		• Koha e larjes mund të ndryshojë sipas sasisë të rrobave, presionit të ujit, temperaturës të ujit dhe kushteve të tjera të përdorimit. Nëse zbulohet mungesë balancimi ose nëse programi i heqjes të shumës është i ndezur, koha e larjes do të rritet.
Derdhje e zbutësit të rrobave	Zbutësi i tepërt i rrobave mund të shkaktojë derdhje.	• Ndiqni udhëzimet e zbutësit për t'u siguruar që të përdoret sasia e duhur. Mos e tejkaloni vijën maksimale të mbushjes.
Zbutësi është futur shumë herët		• Mbylleni sirtarin e dispenserit me ngadalë. Mos e hapni sirtarin gjatë ciklit të larjes.
Problem me tharjen	Nuk than	• Mos e mbingarkoni. Kontrolloni që lavatriçja zbrazet mirë për të nxjerrë ujin nga ngarkesa. Ngarkesa e rrobave është shumë e vogël për t'u tundur mirë. Shtoni disa peshqirë.



Mesazhe Gabimi









Simptomat		Arsyeja	Zgjidhja
		Furnizimi me ujë nuk është i përshtatshëm në vend.	Kontrolloni një rubinet tjetër në shtëpi.
		Rubinetet e furnizimit me ujë nuk janë hapur plotësisht.	Hapeni plotësisht rubinetin.
		Tubi(at) e hyrjes të ujit janë përdredhur.	Drejtoni tubin(at).
		Filtri i tubit(ave) të hyrjes janë bllokuar. Nëse ndodh rrjedhje uji në tubin e hyrjes, treguesi 'A' do të bëhet i kuq.  Mund të ndryshojë në varësi të modelit.	Kontrolloni filtrin e tubit të hyrjes.
		Tubi i shkarkimit është përdredhur ose bllokuar.	Pastroni dhe drejtoni tubin e shkarkimit.
		Filtri i shkarkimit është bllokuar.	Pastroni filtrin e shkarkimit.
		Ngarkesa është shumë e vogël.	Shtoni 1 ose 2 gjëra të ngjashme për të ndihmuar balancimin e ngarkesës.
		Ngarkesa nuk është e balancuar.	Shtoni 1 ose 2 gjëra të ngjashme për të ndihmuar balancimin e ngarkesës.
		Pajisja ka një sistem zbulimi dhe korrigjimi të mungesës të balancimit. Nëse futen gjëra të rënda teke (p.sh. mat banjoje, rrobdeshan, etj.) ky sistem mund të ndalojë rrotullimin ose edhe të ndërpresë ciklin e centrifugës së bashku.	Përhapni ngarkesën për të lejuar centrifugim të mirë.
		Nëse rrobat janë akoma të njoma në fund të ciklit, shtoni gjëra më të vogla për të balancuar ngarkesën dhe përsëritni ciklin e centrifugës.	Përhapni ngarkesën për të lejuar centrifugim të mirë.




Simptomat		Arsyeja	Zgjidhja
	  	Sigurohuni që dera të mos jetë e hapur.	Mbylleni derën plotësisht. Nëse 'dE', 'dE 1', 'dE 2' nuk lëshohet, thërrisni shërbimin.
			Hiqeni spinën e energjisë dhe thërrisni shërbimin.
		Uji derdhet për shkak të defektit në valvulën e ujit.	- Mbylleni rubinetin e ujit. - Hiqeni spinën e energjisë. - Thërrisni shërbimin.
		Sensori i nivelit të ujit nuk funksionon mirë.	- Mbylleni rubinetin e ujit. - Hiqeni spinën e energjisë. - Thërrisni shërbimin.
		Mbingarkesë në motor.	Lëreni lavatricjen të rrijë për 30 minuta dhe që të ftohet motori, pastaj filloni përsëri ciklin.
		Rrjedhje uji.	Thërrisni shërbimin.

Kjo garanci e kufizuar nuk mbulon:

- Udhëtimet e shërbimit për të dërguar, marrë ose instaluar apo riparuar produktin; udhëzimet për klientin për përdorimin e produktit; riparimi ose ndërimi i siguresave ose rregullimi i instalimeve elektrike ose hidraulike, ose korigjimi i paautorizuar i riparimeve/instalimeve.
- Defekte të produktit gjatë defekteve dhe ndërprerjeve të energjisë ose shërbimit elektrik të papërshtatshëm.
- Dëmtime të shkaktuara nga tuba që rrjedhin ose të çarë, tuba të ngrirë, linja shkarkimi të bllokuara, furnizim me ujë të papërshtatshëm ose të ndërprerë ose ajër të pamjaftueshëm.
- Dëmtime që vijnë nga përdorimi i Produktit në një atmosferë gërryese ose në kundërshtim me udhëzimet e përcaktuara në manualin e përdorimit të Produktit.
- Dëmtime në produkt të shkaktuara nga aksidentet, insektet dhe krimbat, ndriçimi, era, zjarri, përmytjet ose veprat e Zotit.
- Dëmtime ose defekte të shkaktuara nga modifikimi ose ndryshimi i paautorizuar, ose nëse përdoret për qëllime të tjera përveç qëllimit të synuar, ose çdo rrjedhje uji aty ku produkti nuk është instaluar mirë.
- Dëmtime ose defekte të shkaktuara nga rryma elektrike, tensioni i gabuar ose kodet hidraulike, përdorim tregtar ose industrial, ose përdorim i aksesorëve, komponentëve ose produkteve të pastrimit që nuk janë aprovuar nga LG.
- Dëmtime të shkaktuara nga transporti dhe lëvizja, përfshirë gërvishjet, dhëmbëzimet, ciftat, dhe/ose dëmtimet e tjera në lustrën e produktit, përveç nëse këto dëmtime vijnë nga defekte në materiale ose prodhim.
- Dëmtim ose gjëra që mungojnë në ekran, kutia e hapur, Produkti i ndërprerë ose i riparuar.
- Produktet me numrat e serisë origjinale që janë hequr, ndryshuar ose që nuk mund të përcaktohen. Modeli dhe Numrat e serisë, së bashku me faturën origjinale të shitjes, kërkohen për verifikimin e garancisë.
- Rritje në kostot e utiliteteve dhe shpenzime shtesë utilitetesh.
- Riparimet kur Produkti juaj përdoret ndryshe nga normalisht ose në kundërshtim me udhëzimet e përcaktuara në manualin e përdorimit të Produktit.
- Kostot që lidhen me heqjen e Produktit tuaj nga shtëpia për riparime.
- Heqja dhe ri-instalimi i Produktit nëse është instaluar në një vend të paarrtshëm ose nuk është instaluar në përputhje me udhëzimet e botuara të instalimit, përfshirë manualin e përdorimit dhe manualet e instalimit të LG.
- Dëmtime që vijnë nga keqpërdorimi, abuzimi, instalimi i gabuar, riparimi ose mirëmbajtja. Riparimi i gabuar përfshin përdorimin e pjesëve që nuk janë aprovuar apo përcaktuar nga LG.

Dridhje ose zhurmë e çuditshme e shkaktuar nga mos heqja e bulonave të transportit ose mbajtëses të kazanit.		Hiqni bulonat e transportit & mbajtësen e kazanit.
Rrjedhje të shkaktuara nga papastërtitë (qimet, pushi) në guarnicion dhe xhamin e derës.		Pastroni guarnicionin & xhamin e derës.

Mos shkarkim i shkaktuar nga bllokimi i filtrit të pompës.	➔		Pastroni filtrin e pompës.
Nuk vjen ujë për shkak se filtrat e valvulës të hyrjes të ujit janë bllokuar ose tubat e hyrjes të ujit janë përdredhur.	➔		Pastroni filtrin e valvulës të hyrjes ose instaloni përsëri tubat e hyrjes të ujit.
Nuk vjen ujë për shkak se është përdorur tepër detergjent.	➔		Pastroni sirtarin e dispenserit të detergjentit.
Rrobat janë të nxehta ose të ngrohta pas larjes sepse tubat e hyrjes të ujit janë instaluar mbrapsht.	➔		Instaloni përsëri tubat e hyrjes.
Uji nuk vjen sepse rubineti i ujit nuk është hapur.	➔		Hapeni rubinetin e ujit.
Rrjedhje të shkaktuara nga instalimi i gabuar i tubit të shkarkimit ose nga bllokimi i tij.	➔		Instaloni përsëri tubin e shkarkimit.
Rrjedhje të shkaktuara nga instalimi i gabuar i tubit të hyrjes të ujit ose nga përdorimi i tubave të markave të tjera.	➔		Instaloni përsëri tubin e hyrjes.
Problemi i mos ndezjes i shkaktuar nga lidhja e lirë e kabllit të energjisë ose priza elektrike.	➔		Lidhni përsëri kabllin e energjisë ose ndryshoni prizën elektrike.

Udhëtime shërbimi për të dërguar, marrë, instaluar produktin ose për udhëzime mbi përdorimin e produktit. Heqja dhe ri-instalimi i Produktit.	➔	 Niveli	Garancia mbulon vetëm defektet e prodhimit. Shërbimet që vijnë nga instalimi i gabuar nuk mbulohen.
Nëse të gjitha vidat nuk instalohen mirë, mund të shkaktojë dridhje të mëdha (Vetëm modeli me pedestal).	➔		Instaloni 4 vidat në secilin cep (Total 16EA).
Zhurmë goditjeje uji (kërcitje) kur lavatrica mbushet me ujë.	➔	 Presion Uji i Lartë Rrjedhë uji natyrale, Ndalim i papritur i rrjedhës të ujit Goditjet Zhurmë e lartë	Rregulloni presionin e ujit duke mbyllur valvulën e ujit ose rubinetin e ujit në shtëpi.

TË DHËNAT E PUNITIT

Skeda e produktit - Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) Nr 1061/2010

Emri ose marka e furnitorit	LG	
Modeli i furnitorit	F14U1JBS(0-9)	
Kapaciteti nominal	10	kg
Kategoria e efikasitetit të energjisë	A+++	
Vlerësuar me "Çmimin Ecolabel të BE-së" sipas Rregullores (KE) Nr 66/2010	Jo	
Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë (AEC) në kWh në vit bazuar në 220 cikle standarde larjeje për programet e pambukut në 60 °C dhe 40 °C me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme, dhe me konsum në regjimet me fuqi të ulët. Konsumi aktual i energjisë do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes.	143	kWh/vit
Konsumi i energjisë		
programi standard 60 °C i pambukut në ngarkesë të plotë	0.67	kWh
programi standard 60 °C i pambukut në ngarkesë të pjesshme	0.63	kWh
programi standard 40 °C i pambukut në ngarkesë të pjesshme	0.55	kWh
Konsumi i ponderuar i fuqisë së regjimit fikur dhe të regjimit lënë ndezur.	0.45	W
Konsumi i ponderuar vjetor i ujit (AWC) në litra në vit bazuar në 220 cikle standarde larjeje për programet e pambukut në 60 °C dhe 40 °C me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme. Konsumi aktual i ujit do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes.	9900	litra/vit
Kategoria e efikasitetit të tharjes me centrifugim në një shkallë nga G (më pak efikas) deri në A (më shumë efikas).	A	
Shpejtësia maksimale e centrifugimit për programin standard 60 °C për pambukun në ngarkesë të plotë ose programin standard 40 °C për pambukun në ngarkesë të pjesshme, cilado është më e ulët, dhe përmbajtja e mbetur e lagështirës e arritur për programin standard 60 °C për pambukun në ngarkesë të plotë ose programi standard 40 °C për pambukun në ngarkesë të pjesshme, cilado është më e madhe.	1400	rpm
	44	%
Programet standarde të larjes me të cilat lidhet informacioni në etiketë dhe skedë, se këto programe janë të përshtatshme për të pastruar rrobat prej pambuku me ndotje normale dhe se ato janë programet më efikase në lidhje me konsumin e kombinuar të energjisë dhe ujit;	"Të pambukta të mëdha 60 °C/40 °C"	
Koha e programit		
programi standard 60 °C i pambukut në ngarkesë të plotë	296	min.
programi standard 60 °C i pambukut në ngarkesë të pjesshme	270	min.
programi standard 40 °C i pambukut në ngarkesë të pjesshme	261	min.
Kohëzgjatja e regjimit lënë ndezur (TI)	10	min.
Emetimet e zhurmës akustike në ajër të shprehura në dB(A) re 1 pW dhe të rrumbullakosura në numrin më të afërt gjatë fazave të larjes dhe centrifugimit për programin standard 60 °C për pambukun në ngarkesë të plotë	55 / 73	dB(A)
Me qëndrim të lirë		

Memo

Memo

Memo

